



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE PËR LUFTËN KUNDËR FALSIFIKIMIT TË
MONEDHËS”**

- **Hyrje**

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për luftën kundër falsifikimit të monedhës”.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë.

- **Baza kushtetuese e projektligjit**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

• Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi i këtij projektligji është aderimi i Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për luftën kundër falsifikimit të monedhës.

Kjo konventë është nënshkruar në Gjenevë, në 20 prill 1929, me dëshirën për ta bërë gjithnjë e më efektiv parandalimin dhe dënimin e falsifikimit të monedhës.

Nëpërmjet aderimit në këtë konventë synohet bashkëpunimi mes shteteve anëtare dhe shkëmbimi i informacionit. Ky i fundit parashikohet të realizohet nëpërmjet një Zyre Qendrore, e cila ka si mision centralizimin e të gjithë informacionit dhe lehtësimin kështu të hetimit, parandalimit, dhe dënimit të falsifikimit të monedhës.

Aderimi në këtë Konventë, siç parashikon dhe Neni 23 i Konventës, nënkupton që legjislacioni i palës kontraktuese dhe organizimi i saj administrative do të jenë në përputhje me rregullat që përmban kjo konventë.

Pjesa e parë e Konventës përcakton:

- rregullat për të siguruar parandalimin dhe dënimin e veprës së falsifikimit të parave.
- Përcaktimin e fjalës “monedhë” (monedhën letër dhe monedhën metalikë, qarkullimi i të cilave është i autorizuar ligjërisht).
- Përcaktimin e veprës penale të falsifikimit të monedhës.
- Rregullime për parimin e ekstradimit të shtetasve. (Në vendet ku nuk njihet ekstradimi i shtetasve, shtetasit që janë kthyer në territorin e vendit të tyre, pasi kanë kryer jashtë vendit një vepër të falsifikimit të monedhës, duhet të dënohen në të njëjtën mënyrë sikur vepra të ishte kryer në territorin e tyre.)
- Masat ligjore për sekuestrimin dhe konfiskimin e monedhës së falsifikuar, transmetimin e mostarve dhe kopjeve tek Zyra Qendrore në rastet kur ligji vendas kërkon ruajtjen e tyre si dosje për hetimin penal.
- Funksonimin e Zyrës Qendrore, parimet e komunikimit mes palëve, me qëllim centralizimin e informacionit dhe përcjelljen e tij me qëllim dhënien e ndihmës në procesin e hetimit dhe ndjekjes penale.
- Rregullimin e transmetimit dhe ekzekutimit të letër kërkesave nga palët kontraktuese.
- Konventa parashikon që veprat e lidhura me falsifikimin e monedhës, duhet të përcaktohen dhe të dënohen në përputhje me rregullat e përgjithshme të legjislacionit vendas.

Ndërsa **pjesa e dytë** parashikon dispozitat përfundimtare për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente dhe rregullimin ligjor për aderimin ose tërheqjen nga Konventa.

Nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje **nuk do të ketë efekt financiare** në buxhetin e shtetit, pasi Zyra Qendrore do të pozicionohet në ndërtesën aktuale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe punonjësit do të jenë pjesë e strukturës aktuale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Në aspektin e **teknikës legjislative**, plotësohen të gjitha kërkesat formale të një marrëveshjeje.

- **Diskutimi në komision**

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit, për të shpjeguar nismën dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishte një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, i cili sqaroi rëndësinë e aderimit të Republikës së Shqipërisë në këtë Konventë dhe ju përgjigj pyetjeve të deputetëve, anëtarë të komisionit. Përfaqësuesit e ministrisë sqaruan se projektligji është planifikuar në programin kombëtar të integritetit evropian, kapitulli 24 “Drejtësia, liria dhe siguria”, si dhe është planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projekt akteve, për Ministrinë e Brendshme për vitin 2019. Deputetët kërkuan informacion lidhur me efektet financiare të projektligjit dhe pasi morën përgjigje vlerësuan nismën e propozuar dhe nevojën për aderimin e Shqipërisë në këtë konventë.

Komisioni vlerësoi se **në aspektin ligjor**, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe **në aspektin procedural**, është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim të diskutimeve, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

RELATOR

KRYETARE

ELONA GJEBREA

MIMI KODHELI